



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 08.11.2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

ME
OBJEKT

**“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS “KORABI” ,NJ.A FUSHE
KRUJË,BASHKIA KRUJE”**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date 08.11.2024 ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit ‘E Hapur e Thjeshtuar’ dhe ne referim te urdherit te prokurimit nr. 534 Date 6.11.2024, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim-Asfaltim I Rrugës “Korabi” ,Nj.A Fushe Krujë,Bashkia Kruje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pune Ndertimi / (45000000-7)

VLERA E FONDIT LIMIT: : 2’771’241.17 (dy milion e shtateqind e shtatedhete e nje mije e dyqind e dyzet e nje presje shtatembedhete) lekë pa t.v.sh

BURIMI I FINACIMIT:Te ardhurat e Bashkise Kruje.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne masen prej 2 % te vleres te fondit limit)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2024 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2024 per secilin operator)

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2024 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2024 per secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2-a)Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

2.1.2-b):Ofertuesi duhet të paraqesi licensen profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura/MIE.

- **Shoqëria ofertuese duhet të paraqesi licensen e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:**
- **NP-1/A** Punime gërmimi në tokë.
- **NP-4/A** Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- **NS-6/A** Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- **NS-18/A** Punime topogjeodezike.

Shenim-Licensa duhet të jetë leshuar në përputhje me kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar me VKM nr nr. 92 datë 19.02.2014.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008 ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP.1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi në tokë. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve të gjurmimit, sipas zërit nr.1, 2, 3 të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NP.4	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo e pista aeroportuale.	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve rrugore, sipas zërit nr.4, 5, 6, 7, 8, të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punime topogjeodezike. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve topogjeodezike, sipas të gjithë	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

		zërave nr.1, 2, 4, 5, 6, 7 të punimeve rrugore të preventivit.		
NS-6	Sinjalistike rrugore jondricuese ura,	Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve të sinjalistikës rrugore, sipas zërit nr.9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, të preventivit	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.a- Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021'2022'2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore

2.2-b Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 20212022-2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt -Eksptizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të

realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros se kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rendesishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e nën kufirin e ulët monetar dhe iu jep mundësi tjerë të tjerë dhe operatoreve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Teresia e kriterëve që i përkasin kapacitetit teknik si pjesë integrale e kriterëve të vecanta është hartuar nga DPZHT, dhe janë përcjelle në NJ.P.P me shkresën nr. Prot 7718 date 06.11.2024 .

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 (pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pese) viteve të fundit , është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

c) Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

d) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i-Per punimet e kryera në sektorin publik duhet të paraqiten dokumentacioni provues si vijon:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje

- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përfundimtare e deklaruar ne organet tatimore
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim

ii-Ndersa ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

- Kontraten e sipermarrjes
- Situacionin përfundimtar
- Akt kolaudimin
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- Faturat tatimore te shitjes e deklaruar ne organet tatimore

(Elementet provues te mesiperm jane kerkuar ne referim te legjislacionit perkates ne fuqi per disiplinimin e kontrollin e punimeve te ndertimit e me konkretisht ne referencat e dizpozitive te Ligjit Nr.8402, Date 10.9.1998 ‘Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit’ i ndryshuar ,dhe VKM nr 408 date Nr. 408, datë 13.5.2015’ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’ i ndryshuar.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat., 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se vlera e fondit limit te objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Marzhi i mesiperm eshte konsideruar i tille qe pare ne aspektin e ofertimit iu jep mundesi dhe akses pjesemarrje ne konkurim edhe subjekteve ofertues te cilet jane biznese te vegjel ose te mesem duke zgjeruar hapesiren e ofertimit.

2.3.3-Operatoret ekonomik pjesmarres duhet te paraqesin nje vetedeklarim(leshuar nga administratori i shoqerise ofertuese) qe brenda te njejtes periudhe nuk eshte kontraktor/nenkontraktor per kontrate /apo kontrata te lidhura me vlere te perbashket ose te vecante jo me e madhe se 100% i kufirit maksimal qe disponon kandidati sipas licenses profesionale , te leshuar nga autoriteti kompetent .

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 26 pika 7 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi.

2.3.3-a).Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë ne perberje te stafit Teknik te perhershëm dhe te rezultojne ne listpagesat e shoqerise, si më poshtë **per te cilen duhet te paraqese kontratë pune te vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit te sherbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.**

- **Inxhinier Ndertimi** **1**
- **Inxhinier Gjedodet/Topograf** **1**

b).Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë ne perberje te stafit menaxherial te perhershëm dhe te rezultojne ne listpagesat e shoqerise, si më poshtë per te cilen duhet te paraqese kontratë pune te vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit te sherbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

Drejtues Teknik 1

2.3..3 c .Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera , të figurojë në listpagesat e shoqërisë me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera , ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. **285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje afat **kohor prej 20 (njetzet) dite** i cili

kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate. Kapaciteti per fuqi punetore inxhinierike per stafin e kerkuar inxhinierik bazohet në K.Punës, dhe ne V.K.M. nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar dhe lidhet ngushtesisht me nevojën për realizimin në kohe të objektit të kontratës duke iu referuar zbatimit të punimeve, si dhe në përputhje me zerat dhe volumet e punimeve të preventivit sipas projektit të zbatimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4.-Personeli dhe fuqia punetore:

Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për ekzekutimin e kontratës dhe për të provuar këto kusht duhet të ketë **një punësim mesatar për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, i të paktën 17(shtatëmbëdhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm, stafin menaxherial dhe specialist dhe punetore, të provuar me :**

- Vertetim të leshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatës ose vertetim leshuar nga platforma elektronike E-Albania
- Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014” **Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”**

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave**, tregon besueshmëri/garanci për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën **17(shtatembedhjete) persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3-5-Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe Teknik

a. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht **4 (kater) punonjës** manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda (**specifikisht nje per manovrator per eskavator ,nje per asfalto-shtruese dhe dy per rrul vibrues/grejder**).

Për çdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithe periudhes se realizimit te kontrates), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme) dhe lejet e drejtimit të lëshuara nga institucionet përkatëse .

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje

me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu për profilin e manovratorëve është marrë në konsideratë direktë natyra e zerit të punimeve përkatëse të cilët mund të zbatohen vetëm nëpërmjet proceseve të mjeteve e makinerive të vecanta ose të renda të cilat janë kërkesë funksionale e realizimit të zerave të punimeve.

2.3.6-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet të disponojë makinerite dhe mjetet si vijon në pronesi ose me qera.

I.MAKINERI	Njesia	Sasia	Pronesia
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Kamionçinë nën 3.5 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
Grejder.	copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
II.PAJISJE			
Jelekë fosforeshentë.	copë	17	Pronësi ose me qera
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera

Kallëp dërrase.(armaturë).	m2	10	Pronësi ose me qera
Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	17	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b) *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcës nr.8** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar zerave respektiv te punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në fuqi për disiplinimin e punimeve të ndërtimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3. 8 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

- Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë përcjelle nga ana e DPKZHT - se, Ne hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

- **Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'' i ndryshuar, nga DPKZHT, percjelle njesise se prokurimit sipas shkreses nr. 7718 Prot. Date 06.11.2024''**

NJESIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

EGLANTINA SUBASHI

MELISA KUPA

MIKEDA CACA